



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësia Org. Org. Jedini. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1520
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	2	Data Datum Date:	03/08/2018
Hyrië PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	31.07.2018
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e komunave, Drejtorët e drejtorive komunale, Zyrtarët kryesor financiar
NGA/OD/FROM:	Bedri Hamza, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2019/02 për Komuna



Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Po ju dërgojmë Qarkoren Buxhetore 2019/02 për komuna, përmes së cilës ju njoftojmë për udhëzime mbi strukturën e shpenzimeve për vitin 2019 dhe parashikimet për vitet 2020-2021, sipas kufijve të financimit komunal të dhënë me Qarkoren Buxhetore 2019/01 të datës 15 maj 2018, dhe në pajtim me rregullat e aplikueshme fiskale.

Kjo qarkore është nxjerrë në përputhje me kompetencat ligjore të Ministrisë së Financave, sipas nenit 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Udhëzimet e dhëna në këtë qarkore mbi strukturën e shpenzimeve bazohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021 (KASH), ku përcaktohet niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve afat-mesme për buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Ju lutem të keni parasysh udhëzimet në këtë qarkore në përgatitjen e propozim-buxhetit për komunën tuaj për vitin 2019 dhe për parashikimet afatmesme 2020-2021. Siç e dini, Ministria e Financave ka organizuar forume dhe takime konsultuese gjatë muajit korrik 2018 me të gjitha komunat për zhvillimin e procesit buxhetor komunal.

Për informata shtesë apo ndihmesë lidhur me cilindo element të kësaj qarkore, ju lutem kontaktoni analistët e buxhetit në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Me respekt!

Bedri Hamza,
Ministër i Financave

1. Parimet bazë për përgatitjen e buxhetit komunal 2019-2021

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të ruaj stabilitetin makro-fiskal, dhe brenda një kornize të qëndrueshme buxhetore të ofrojë mundësinë e financimit të prioriteteve strategjike.

Bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Po ashtu, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e shërbimeve sociale.

Në këtë qarkore janë marrë parasysh prioritetet e Qeverisë, duke ruajtur kështu raportin në mes të shpenzimeve rrjedhëse dhe shpenzimeve kapitale.

Shpenzimet rrjedhëse: Krahasuar me vitin paraprak, është ofruar hapësirë për një rritje të theksuar të kategorisë së shpenzimeve për paga dhe mëditje si dhe mallra dhe shërbime.

Në kategorinë e shpenzimeve **paga dhe mëditje** rritja është e dedikuar për arsimin parauniversitar në veçanti, dhe rrjedh nga aprovimi i politikave të reja nga Komisioni i Granteve, gjegjësisht asistencën për fëmijë me nevojë të veçanta, dhe pagesën e tri pagave pas pensionimit.

Në kategorinë e shpenzimeve **mallra dhe shërbime** rritja dedikohet në:

- politikat e reja në arsimin parauniversitar, gjegjësisht ofrimin e mbështetjes buxhetore për kryerjen e praktikës profesionale (politikë e aprovuar nga Komisioni i Granteve),
- zgjerimin e mbështetjes buxhetore për shëndetësinë primare,
- mbulimin e nevojave të financimit për menaxhimin e mbeturinave, dhe
- adresimin e *keq-klasifikimeve ekonomike* të mjeteve në kuadër të shpenzimeve kapitale (mjete këto që sipas natyrës i përkasin shpenzimeve për mallra dhe shërbime).

Në kategorinë e shpenzimeve **shpenzimet komunale** ka rritje krahasuar me vitin paraprak, bazuar në rritjen e vazhdueshme të obligimeve komunale.

Po ashtu edhe në kategorinë e shpenzimeve **subvencione dhe transfere** ka rritje krahasuar me vitin paraprak (planifikimi në kategorinë subvencione dhe transfere duhet të bëhet nga të hyrat vetanake komunale).

Fondet e huamarrjes në shëndetësi dhe arsim janë shpërndarë nëpër komuna të caktuara sipas planit të dorëzuar nga ministritë e linjës.

Shpenzimet kapitale: Sa i përket shpenzimeve kapitale, me anë të kësaj qarkoreje ofrohet hapësirë për një rritje më të theksuar të investimeve publike lokale si rezultat i rritjes së financimit total komunal për vitin 2019-2021.

Gjatë procesit të planifikimit të investimeve kapitale, në pajtim me detyrimet ligjore, secila komunë duhet fillimisht të planifikoj burime për financimin e plotë të projekteve që janë në vijim e sipër.

Komunat mund të planifikojnë projekte të reja nëse buxheti i planifikuar ofron hapësirë shtesë mbi obligimet për implementimin e projekteve ekzistuese, përfshirë edhe projektet me bashkëfinancim me ministritë e linjës apo me donatorët potencial.

Gjatë planifikimit të projekteve kapitale duhet të keni parasysh strukturën ekzistuese të planit kontabël, me qëllim të zbatimit adekuat të klasifikimeve ekonomike të cilat verifikohen përmes procesit të auditimit.

Udhëzime rreth planifikimit të buxhetit:

Për të ruajtur disiplinën fiskale dhe në bazë të detyrimeve ekzistuese ligjore, organizatave buxhetore nuk ju lejohej të rrisin koeficientët e pagave dhe të shtojnë numrin e punëtorëve përtej kufizimeve të dhëna me ligjin e buxhetit. Punësimi i stafit të ri duhet të bëhet në përputhje me masën monetare në dispozicion për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje për vitin 2019 dhe parashikimet 2020-2021. Duhet gjithashtu të respektohen dispozitat ligjore me rastin e pagesës së punës pas orarit të rregullt të punës. Çdo mosrespektim i këtyre kufizimeve nga organizata buxhetore është hyrje në obligim pa mbulesë, dhe rrjedhimisht paraqet shkelje të LMFP-së dhe Ligjit vjetor të buxhetit.

Shpenzimet rezidenciale janë të shpërndara sipas kategorive të shpenzimeve përkatëse brenda strukturës së përgjithshme të shpenzimeve të komunave. Për të siguruar ofrimin e shërbimeve rezidenciale, komunat obligohen të zbatojnë udhëzimet e MPMS-së për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nëpër kategori të ndryshme të shpenzimeve në nën programin e Shërbimeve Rezidenciale brenda kufijve të financimit për Shërbimet Rezidenciale të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve dhe pasqyruar në Qarkoren Buxhetore 2019/01.

Ligji për Kryeqytetin:

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, neni 19 Kryeqyteti Prishtina përfiton një grant shtesë nga niveli qendror, në lartësi jo më pak se 6% e grantit të përgjithshëm.

Për vitin 2019 Kryeqyteti, Prishtina përfiton grant shtesë prej 10,841,400 euro, ndërsa për vitin 2020 përfiton 11,479,800 euro dhe për vitin 2021 përfiton 12,207,000 euro.

Shpërndarja e financimit të grantit shtesë për kryeqytetin për shpenzim sipas kategorive ekonomike do të bëhet pas evidentimit detaj të projekteve dhe nismave, si dhe vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me Ligjin për Kryeqytetin.

Ligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit:

Me anë të ligjit të buxhetit për vitin 2019, do të krijohet mekanizmi për transferimin e pranimeve nga renta minerale e arkëtuar nga buxheti qendror për alokime në komunën e Obiliqit.

Për vitin e parë të implementimit, bazë për përllogaritjen e financimit ekzistues do të jetë arkëtimi i vitit paraprak. Ministria e Financave ruan të drejtën e vlerësimit të ndryshimeve në arkëtimet e rentës, dhe vendosjen e mekanizmave korrektues në rast të ndryshimeve në arkëtim.

2. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitet 2019-2021 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të lëshuar me këtë qarkore. Tabela që paraqet strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitin 2020-2021 për komuna është dhënë në aneks 1.

3. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ)

Komunat duhet të adresojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor sipas udhëzimeve të dhëna me Qarkoren Buxhetore 2019/01.

4. Dorëzimi i propozim-buxhetit komunal për vitet 2019-2021

Pas aprovimit të propozim-buxhetit për vitin 2019-2021 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave deri me datë 30 shtator 2018. Propozim buxheti i aprovuar duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- ✓ Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- ✓ Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2019-2021, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- ✓ Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2019-2021 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2019 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2020-2021 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjzinor.

Aneksi I: Struktura e shpenzimeve për buxhetin komunal për vitin 2019 dhe parashikimet për vitet 2020-2021

Nr. Komunit	Nr. idë përcaktuese	Paga dhe Metriqja	Mallëra dhe Shërbime	Shpenzime Komunalet	Subvencione dhe Transferime	Shpenzime Kapitale	Total 2019	Vlerësimet për vitin 2020			Vlerësimet për vitin 2021			
								Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2020	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2021	
1	Degani	5,399,876	1,230,474	155,500	90,000	2,073,506	8,951,356	6,873,830	2,392,971	9,268,821	6,992,819	2,730,384	9,633,233	
2	Drapash	4,568,960	868,968	130,000	50,000	2,786,784	8,404,652	5,612,868	3,134,385	8,752,253	5,660,713	3,475,797	9,116,509	
3	Ferizaj	15,500,748	4,199,994	622,630	605,692	10,005,732	30,934,846	20,929,114	11,020,007	31,949,121	21,006,618	12,041,830	33,048,438	
4	Fishk Kosovë	4,848,709	1,301,707	200,000	204,657	4,432,660	11,097,733	6,645,073	4,831,660	11,466,733	6,660,317	5,187,117	11,857,034	
5	Gjakovë	13,701,106	2,832,316	386,800	468,000	7,176,951	24,785,173	17,608,222	8,026,854	25,635,076	17,676,728	9,904,979	26,581,707	
6	Gjiljan	15,436,123	3,710,000	671,500	608,936	5,082,228	25,508,786	20,426,559	5,043,723	26,370,282	20,503,739	6,288,748	27,292,488	
7	Gjorgec	8,423,505	1,716,041	188,113	231,347	4,611,596	15,171,602	10,560,006	5,097,148	15,657,154	10,602,124	5,356,687	16,108,811	
8	Hani i Elezit	1,493,148	263,236	54,400	61,104	1,044,033	2,915,921	1,871,888	753,641	2,625,529	1,879,354	838,346	2,717,700	
9	Isroë	6,065,251	1,345,525	155,000	250,000	2,861,539	10,678,115	7,816,776	3,245,203	11,062,009	7,947,107	3,618,080	11,465,187	
10	Jamuk	1,127,723	172,899	36,200	30,500	417,443	1,284,765	1,367,322	169,008	1,536,330	1,372,961	221,232	1,594,193	
11	Kaçanik	5,102,663	900,000	160,000	206,540	2,012,431	8,381,631	6,369,203	2,282,780	8,651,903	6,394,716	2,569,301	8,964,018	
12	Kamëricë	7,074,926	986,558	184,000	100,000	904,363	9,219,847	8,315,484	1,248,925	9,564,409	8,359,859	1,580,028	9,939,887	
13	Kitëvë	6,042,572	1,070,934	180,000	105,000	2,760,442	10,138,948	7,398,506	3,098,566	10,448,072	7,428,719	3,389,515	10,818,234	
14	Leposaviq	2,335,204	405,228	64,000	70,000	1,767,641	4,642,073	2,824,432	1,519,070	4,393,502	2,886,108	1,709,674	4,595,782	
15	Lubin	9,280,000	1,470,000	250,000	350,000	4,546,971	15,896,971	11,350,000	5,051,341	16,401,341	11,396,400	5,575,791	16,972,191	
16	Mallëshevë	8,212,895	1,389,525	305,000	105,000	4,335,559	14,347,979	10,012,420	4,769,027	14,781,447	10,053,484	5,228,059	15,281,544	
17	Marruthe	968,385	267,426	30,212	27,844	690,893	1,984,760	1,293,867	474,981	1,768,848	1,298,709	542,266	1,840,975	
18	Mitrovicë	12,025,408	2,398,833	493,815	530,043	4,280,666	19,728,815	15,448,149	4,916,474	20,364,623	15,509,276	5,558,359	21,066,635	
19	Novobredë	1,903,481	309,716	66,000	30,000	472,442	2,781,639	2,309,197	243,597	2,552,794	2,318,714	323,900	2,642,614	
20	Ohrid	3,939,539	600,000	250,000	150,000	2,297,054	7,196,593	4,939,539	1,830,125	6,769,664	4,959,237	2,036,026	6,995,263	
21	Palë	14,216,617	3,224,859	731,924	331,000	8,072,010	26,598,410	18,526,400	9,001,354	27,527,754	18,597,483	9,097,768	28,535,251	
22	Podujevë	12,482,542	2,178,773	460,000	610,000	6,701,304	22,033,619	15,331,315	7,441,889	22,773,204	15,397,027	8,169,803	23,501,831	
23	Prishtinë	30,704,278	15,011,479	2,000,000	1,800,000	27,276,688	76,892,425	49,615,757	29,885,830	79,501,687	49,769,278	32,490,315	82,759,594	
24	Prizren	20,521,729	6,723,217	1,091,199	600,000	18,764,315	47,430,160	28,666,145	20,495,692	49,161,837	28,767,404	22,271,188	51,034,592	
25	Rahovec	7,435,659	1,514,331	255,500	280,000	4,203,391	13,658,891	9,455,500	4,648,646	14,104,146	9,469,678	5,128,077	14,630,755	
26	Shekull	2,178,903	436,881	83,625	45,000	1,049,760	3,794,171	2,754,411	821,870	3,566,281	2,755,306	999,575	3,664,881	
27	Shitërvë	4,187,283	830,000	199,048	131,766	1,885,868	7,233,985	5,348,117	2,114,618	7,462,735	5,366,053	2,346,074	7,715,127	
28	Shekull	7,805,273	1,480,640	294,537	270,000	3,555,833	13,406,283	9,850,450	3,943,016	13,793,466	9,889,476	4,379,228	14,268,705	
29	Shkup	8,436,110	1,716,144	294,700	300,000	5,501,087	16,248,041	10,756,954	6,033,089	16,790,073	10,789,135	6,580,498	17,349,632	
30	Vit	7,309,561	1,481,703	221,000	210,000	2,121,287	11,345,551	9,222,264	2,526,203	11,748,467	9,258,812	2,923,829	12,182,641	
31	Vushtrri	10,207,561	3,083,495	306,035	190,914	5,376,132	19,119,355	13,793,005	5,913,970	19,706,876	13,844,044	6,546,141	20,390,185	
32	Zablinë	1,550,000	281,460	70,988	91,104	576,532	2,569,693	1,993,541	377,117	2,370,658	2,001,291	476,267	2,476,558	
33	Zogovinë	1,520,000	274,283	70,000	70,000	567,660	2,501,643	1,934,283	339,658	2,274,141	1,941,863	432,218	2,374,101	
34	Zveçmer	2,882,484	1,045,289	150,000	180,859	3,180,546	7,439,178	4,258,632	2,997,478	7,256,110	4,273,044	3,191,018	7,464,062	
35	Kilicën	740,000	137,961	45,000	6,644	332,207	1,241,812	919,605	125,190	1,044,795	923,305	159,223	1,076,528	
36	Mitrovicë Vjetore	3,480,000	601,422	115,706	156,196	1,679,057	6,042,381	4,363,324	1,409,560	5,772,884	4,380,714	1,552,414	5,933,188	
37	Parush	875,000	200,000	40,000	5,000	123,873	1,243,873	1,000,172	60,000	1,060,172	1,017,414	70,000	1,087,414	
38	Randilleg	1,040,966	228,612	30,000	40,000	486,170	1,825,748	1,339,578	299,806	1,629,384	1,344,783	341,593	1,686,376	
Total	Ligji për konvertim e rrezikuar një-difore të Ohrit	370,425,199	67,859,939	11,206,472	9,757,146	155,917,971	515,176,728	359,138,928	168,415,380	527,554,308	360,503,921	185,845,002	546,348,923	
Ligji për Krizëqetimin, Prishtinën						4,972,124	4,972,124		4,972,124	4,972,124		4,972,124	4,972,124	
Total Buxheti Komunal		44,058	270,425,199	67,869,939	11,206,472	9,757,146	160,890,095	530,990,252	359,138,928	173,387,504	544,006,232	360,503,921	190,817,126	563,529,047